



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

---

Numri i lëndës: 2020:051226

Datë: 04.03.2021

Numri i dokumentit: 01563722

**C. nr. 425/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.R. nga ..... të cilën me autorizim e përfaqëson F.S. avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës, të cilën me autorizim e përfaqëson A.H., jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për pagesën e shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit prej 401.32 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqjese, më datën 03.03.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditëses S.R. nga ....., dhe:

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Kamenicës, që paditëses S.R., në emër të shpërblimit të 1 (një) page jubilarë, të i'a paguaj shumën prej 401.32 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 29.04.2020, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**III. DETYROHET** e paditura, që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në shumë të përgjithshme prej 199.00 euro, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

**A r s y e t i m**

Paditësja S.R. nga ....., përmes të autorizuarit të saj F. S., avokat nga Gjlani, më datën 29.04.2020, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.H., jurist nga Kamenica, me objekt kontesti për pagesën e shpërblimit jubilar, me vlerë të kontestit prej 401.32 euro.

Gjykata, duke u bazuar në dispozitën e nenit 401, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së), nuk e ka konvokuar fare seancën përgaditore por, e ka caktuar drejtëpërdrejtë seancën e shqyrtimit kryesor, ngase duke u bazuar në shkresat e lëndës është vlerësuar se kjo çështje juridike kontestimore nuk është e ndërlikuar.

### **1. Pretendimet e palëve ndërgjygjëse**

I autorizuari i paditëses avokati F.S., në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 03.03.2021, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiisë, duke shtuar se paditësi ka mbi 10 vite përvojë pune dhe duke u bazuar në nenin 17, paragrafi 3, nënparagrafi 1, të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, punëdhënësi është i obliguar që paditëses t'ia paguaj shpërblimin jubilar në vlerë të 1 (një) page mujore, si punëdhënës i fundit, e që paga mujore e paditëses sipas listës së pagave është në shumë prej 401.32 euro, për të gjitha këto i ka propozuar gjykatës që t'i administroj provat e bashkëngjitur padisë, tutje ka shtuar se paditësja ka kërkuar edhe përmes procedurës administrative të paditura Komuna e Kamenicës, që e njëjta të i'a paguj në emër të shpërblimit jubilar 1 (një) pagë mujore, por, sipas paditëses, e paditura nuk e ka përmbushur këtë obligim, ndërsa në fjalën përfundimare ka kërkuar nga gjykata që t'a obligoj të paditurën Komunën e Kamenicës, që në emër të shpërblimit jubilar paditëses S. R., t'ia paguaj 1 (një) pagë mujore në shumë të përgjithshme prej 401.32 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumë prej 20.00 euro, për përpilimin e padisë shumë prej 101.00 euro dhe në emër të përfaqësimit në seancën e shqyrtimit kryesor shumë prej 78.00 euro, e në shumë të përgjithshme prej 199.00 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës A. H., në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 03.03.2021, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, pasi që ka shtuar se duke u bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, e paditura në asnjë moment nuk e ka marrë për obligim anën financiare që rrjedhë nga kjo kontratë Kolektive Sektoriale dhe kësaj ka deklaruar se nuk kanë legjitimitet

real pasiv për të qenë palë e paditur, poashtu e ka kundërshtuar edhe lartësinë e pagës të cilën e ka kërkuar paditësja, ngase ka theksuar se paga e paditëses sipas listës së pagave shihet se është 377.00 euro, e jo siç ka kërkuar paditësja në padi shumë prej 401.32 euro, e për të gjitha këto i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses t'a refuzoj si të pa bazuar.

## **2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor**

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe juridike në këtë çështje juridike kontestimore, mori dhe administroj këto prova materiale: Kontratën mbi Marrëdhënien e Punës me nr. 08-144, të datës 08.03.2019, e lidhur në mes të S.R., si punëmarrëse dhe Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, (tutje QKMF-së) në Kamenicë, si punëdhënëse, vërtetimi mbi përvojën e punës, me numër 08-721, i datës 21.11.2019, i lëshuar nga QKMF, në Kamenicë, lista e pagave me numër të nëpunësit EM00042041, në emër të S.R., si dhe kërkesa e paditëses me numër 08-710, e datës 21.11.2019, drejtuar të paditurës Komunës së Kamenicës.

Gjykata, pas vlerësimit dhe analizimit të pohimeve të të autorizuarve të palëve ndërgjygjëse dhe provave materiale të theksuara më lartë, në kuptim të nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdesë dhe më ndërgjegje e ka çmuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar në ligj.

Për palët ndërgjygjëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja është e punësuar te e paditura, por, për të padituren kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses.

Me leximin e kontratës mbi marrëdhënien e punës me nr. 08-144, të datës 08.03.2019, e lidhur në mes të S.R., si punëmarrëse dhe QKMF-së, në Kamenicë, si punëdhënëse, gjykata vërtetoi faktin se paditësja S.R., ka themeluar marrëdhënie pune me periudhë të pacaktuar te e paditura, më datën 08.03.2019, tek e cila ende është duke punuar, dhe nga kjo kontratë gjykata poashtu vërtetoi edhe faktin se paditësja për herë të parë ka themeluar marrëdhënie pune më datën 01.10.2003, në QKMF, në Kamenicë.

Me leximin e vërtetimit mbi përvojën e punës, me numër 08-721, i datës 21.11.2019, i lëshuar nga QKMF, në Kamenicë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja S.R., ka përvoj pune prej 16 viteve.

Me leximin e listës së pagave me numër të nëpunësit EM00042041, në emër të S.R., gjykata vërtetoi faktin se paditësja pagën mujore e argëton - merr në shumë prej 401.32 euro.

Me leximin e kërkesës së paditësit me numër 08-710, e datës 21.11.2019, drejtuar të paditurës Komunës së Kamenicës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Selvete Rahimaj, paraprakisht në procedurë administrative ka kërkuar nga e paditura kompensimin e një page jubilarë, por, nuk ka marr nga e njëjta përgjigje pozitive dhe nuk është kompensuar.

### 3. Baza juridike

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses dhe përcaktimit të lartësisë për shpërblimin jubilar, të 1 (një) page mujore, është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi nga data 11.06.2018, e cila Kontratë mes tjerash parasheh se punëdhënësi (në këtë rastë QKMF, në Komunën e Kamenicës), obligohet që punëmarrëses t'ia paguaj shpërblimin jubilar.

Duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 3, nënparagrafi 1, të Kontratës Kolektive Sektoriale, të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, të hyrë në fuqi nga data 11.06.2018 ku është përcaktuar se *“Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, për 10 vjet të përvojës në punë në institucionet shëndetësore, të punëdhënësi i fundit në vlerë të 1(një) page mujore të tij”*, në rastin konkret gjykata e ka vërtetuar faktin se paditësja S.R., i ka mbi 16 vite përvoj pune dhe se punëdhës i fundit i saj është e paditura QKMF, në Kamenicë, respektivisht Komuna e Kamenicës dhe këtë fakt gjykata e ka vërtetuar përmes kontratës mbi marrëdhënien e punës me nr. 08-144, të datës 08.03.2019, e lidhur në mes të S.R., si punëmarrëse dhe QKMF-së, në Kamenicë, si punëdhënëse, në të cilën shihet se paditësja për herë të parë ka themeluar marrëdhënie pune më datën 01.10.2003, në QKMF, në Kamenicë, si dhe përmes vërtetimit mbi përvojën e punës, me numër 08-721, i datës 21.11.2019, i lëshuar nga QKMF, në Kamenicë, ku shihet se paditësja S.R., ka përvoj pune prej 16 viteve, aq sa kërkohen të plotësohen në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, në mënyrë që një i punësuar në institucionet shëndetësore të ketë të drejtë të shpërblehet në vlerë prej 1 (një) page jubilarë nga punëdhësi i fundit i tyre.

Poashtu duke u bazuar në dispozitën e nenin 90, paragrafi 6, të Ligjit të Punës me Nr.03/L-212, përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës se sa ato të përcaktuara në këtë ligj”*, poashtu konform dispozitës së nenit 8, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me Nr.04/L-077, ku përcaktohet se *“Pjesëmarrësit në*

*marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”, gjykata mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore të lartëcekura e aprovoj kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të bazuar dhe e detyroj të paditurën që t’u përmbush detyrimin e saj ndaj paditësit, të cekur - përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

#### **4. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës**

Gjykata, duke u nisur nga dispozita e lartë përmendur e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 11.06.2018, dispozitave tjera ligjore, si dhe gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë, ka ardhur në përfundim se është në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses S. R.dhe nga kjo arsye edhe e ka detyruar te paditurën që paditëses t’ia paguaj shumën e caktuar si në pikën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi, në emër të shpërblimit jubilar, në vlerë të 1 (një) page mujore, sepse nga provat e administruara u vertetua fakti se paditësja S.R. është në marrëdhënie pune te e paditura me përvojë të punës prej mbi 16 viteve, fakt ky i cili u vërtetua me vërtetimin mbi përvojën e punës, me numër 08-721, i datës 21.11.2019, i lëshuar nga QKMF, në Kamenicë dhe në bazë të kontratës mbi marrëdhënien e punës me nr. 08-144, të datës 08.03.2019, e lidhur në mes të S.R., si punëmarrëse dhe QKMF-së, në Kamenicë, si punëdhënëse, në të cilën shihet se paditësja për herë të parë ka themeluar marrëdhënie pune më datën 01.10.2003, e të cilave prova materiale gjykata u’a fali besimin e plotë dhe i mori për bazë më rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, poashtu në bazë të kërkesës së paditëses me numër 08-710, e dates 21.11.2019, drejtuar të paditurës Komunës së Kamenicës, gjykata e ka vërtetuar edhe faktin se e paditura QKMF, në Komunën e Kamenicë, nuk i’a ka paguar paditëses shumën e mjeteve monetare si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të 1 (një) page mujore edhe pse e ka pasur obligim t’ia paguaj në bazë të dispozitës së lartë përmendur të Kontratës Kolektive Sektoriale, të hyrë në fuqi nga data 12.06.2018.

Ndërsa sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të palës së paditur, se kërkesëpadia e paditësit për kompezimin e 1 (një) page mujore në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite të përvojës së punës, t’a refuzoj si të pa bazuar, për faktin se e paditura nuk ka legjimitet real pasiv, për të qenë pale e paditur, e poashtu në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale, të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, të hyrë në fuqi nga data 11.06.2018, e paditura nuk e ka për obligim përmbushjen e këtyre detyrimeve, për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin

se me nenin 1, të Kontratës Kolektive Sektoriale të lartëcekur, të gjitha QKMF-të, në Kosovë, janë të obliguara ta zbatojnë Kontratën Kolektive Sektoriale të lartëcekur dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, e jo të thirrën se nuk kanë mjete të majftueshme buxhetore, ndërsa sa i përket pretendimit tjetër të përfaqësuesit të të paditurës se paditësja në bazë të koeficientit të paraparë në listen e pagave merr pagë mujore në shumë prej 377.00 euro, e jo 401.32 euro, siq ka kërkuar paditësja në padi, gjykata nuk e mori për bazë, ngase duke u bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të lartë përmendur, për bazë merren pagat e fundit të cilat i merr apo i ka marrur i punësuar nga punëdhënësi, e duke u bazuar në listën e pagave me numër të nëpunësit EM00042041, në emër të S. R., gjykata vërtetoi faktin se paditësja pagën mujore e merr në shumë prej 401.32 euro dhe kësaj prove gjykata i'a fali besimin e plotë, andaj edhe përgjegjësia për kompenzimin e 1 (një) page mujore në emër të shpërblimit jubilar, për mbi 10 vite të përvojës së punës, është te e paditura, respektivisht të QKMF-së, në Komunën e Kamenicë.

Gjykata në lartësinë e aprovuar për kompenzimin e 1 (një) page mujore në emër të shpërblimit jubilar, paditëses i'a ka njohur të drejtën e kamatës ligjore prej 8%, duke filluar nga data 29.04.2020, si datë e paraqitjes së paditës e deri në pagesën definitive, dhe atë në bazë të nenit 382, të LMD-së.

##### **5. Shpenzimet e procedurës kontestimore**

Gjykata, vendosi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452, paragrafi 1, të LPK-së, dhe e detyroj të paditurën, që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 199.00 euro, dhe atë në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumë prej 20.00 euro, për përpilimin e padisë shumë prej 101.00 euro dhe për përfaqësim në një seancë gjyqësore shumë prej 78.00 euro.

Duke u bazuar në të lartëcekurat, si dhe në dispozitën e nenit 143, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**

**C.nr. 425/2020, i datës 03.03.2021**

**G j y q t a r i**

**Artan Abazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.